

VENDIM
Nr. 4, datë 20.2.2013

NË EMËR TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga:

Bashkim Dedja	kryetar i Gjykatës Kushtetuese		
Vladimir Kristo	anëtar i “	“	
Xhezair Zaganjori	anëtar i	“	“
Vitore Tusha	anëtare e	“	“
Fatmir Hoxha	anëtar i	“	“
Admir Thanza	anëtar i	“	“
Altina Xhoxhaj	anëtare e	“	“
Sokol Berberi	anëtar i	“	“

me sekretare Blerina Basha, në datën 17.1.2013 mori në shqyrtim në seancë gjyqësore mbi bazë dokumentesh, çështjen me nr. 53/25 Akti, që i përket:

KËRKUES: Raimonda Trupja

SUBJEKTE TË INTERESUARA: Drejtoria e Përgjithshme Detare; Zyra e Përmbarrimit Durrës

OBJEKTI: Konstatimi i cenimit të së drejtës për një proces të rregullt ligjor, si rrjedhojë e mosekzekutimit të vendimit gjyqësor të formës së prerë brenda një afati të arsyeshëm.

BAZA LIGJORE: Nenet 42, 131/f dhe 134/g të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe neni 6 i Konventës Europiane për të Drejtat e Njeriut.

GJYKATA KUSHTETUESE

pasi dëgjoi relatorin e çështjes, Sokol Berberi, shqyrtoi dokumentet e paraqitura dhe pasi bisedoi çështjen në tërësi,

VËREN:

I

1. Kërkuesja ka qenë punonjëse pranë Kapitenerisë së Përgjithshme të Porteve Durrës (në vijim “Kapiteneria e Porteve”). Me vendimet nr. 173 prot., datë 22.5.2006 dhe nr. 175 prot., datë 25.5.2006 të Kapitenerisë së Porteve, kërkueses i janë ndërprerë marrëdhëniet financiare dhe është liruar nga detyra. Këto vendime janë marrë mbi bazën e vendimit të Këshillit të Ministrave (VKM) nr. 44, datë 27.1.2006 “Për shmangien e nepotizmit në administratën publike”. Me vendimin nr. 20, datë 11.7.2006, Gjykata Kushtetuese ka shfuqizuar VKM-në nr. 44, datë 27.1.2006 “Për shmangien e nepotizmit në administratën publike”, si të papajtueshëm me Kushtetutën. Në këto rrethana, kërkuesja i është drejtuar Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës me padi me objekt “kthimin në punë”.

2. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Durrës, me vendimin nr. 2918, datë 12.12.2006, ka vendosur konstatimin e pavlefshmërisë absolute të zgjidhjes së kontratës së punës mes Kapitenerisë së Porteve dhe kërkueses, detyrimin e rikthimit në punë të kërkueses dhe të pagimit të saj për gjithë periudhën e qëndrimit pa punë, duke filluar nga data 31.5.2006 e deri në ekzekutimin e vendimit gjyqësor.

3. Gjykata e Apelit Durrës, me vendimin nr. 540, datë 3.12.2007, ka lënë në fuqi vendimin e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës. Ky vendim ka marrë formë të prerë dhe, në zbatim të tij, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Durrës ka nxjerrë urdhrin e ekzekutimit nr. 36, datë 21.1.2008.

4. Në datën 7.4.2008, kërkuesja, ka depozituar pranë Zyrës së Përmbarrimit Durrës (në vijim “Zyra e Përmbarrimit”) urdhrin e ekzekutimit dhe kërkesën për zbatimin e vendimit gjyqësor të formës së prerë. Edhe pas kryerjes së disa veprimeve përmbarrimore nga Zyra e Përmbarrimit dhe kërkesave të dërguara nga kërkuesja në drejtim të institucioneve shtetërore përkatëse, rezulton se vendimi gjyqësor i formës së prerë ende nuk është zbatuar.

5. Gjatë kohës së zhvillimit të procesit gjyqësor në gjykatat e juridiksionit të zakonshëm, struktura organizative e Kapitenerisë së Porteve është ndryshuar me urdhrin e Kryeministrit nr. 255, datë 1.11.2006 “Për miratimin e strukturës dhe të organikës së Kapitenerisë së Porteve”. Me anë të urdhrin të Kryeministrit nr. 131, datë 14.6.2010, është miratuar struktura dhe organika e re e Drejtorisë së Përgjithshme Detare (në vijim “Drejtoria Detare”), dhe njëkohësisht është shfuqizuar struktura dhe organika e Kapitenerisë së Porteve, si dhe është suprimuar pozicioni i punës së kërkueses.

6. **Kërkuesja** i është drejtuar Gjykatës Kushtetuese (Gjykata) duke pretenduar cenimin e së drejtës për një proces të rregullt ligjor, si rrjedhojë e mosekzekutimit të vendimit gjyqësor të formës së prerë brenda një afati të arsyeshëm.

7. **Subjekti i interesuar**, Drejtoria Detare, në parashtrimet me shkrim, ka pretenduar pamundësinë objektive për të ekzekutuar vendimin e gjykatës pasi vendi i mëparshëm i punës së kërkueses është suprimuar. Për pasojë, sipas këtij institucioni, rikthimi në punë i kërkueses në vendin e mëparshëm është i pamundur të zbatohet.

II

A. Për pretendimin e cenimit të së drejtës për një proces të rregullt gjyqësor për shkak të mosekzekutimit të vendimit gjyqësor të formës së prerë brenda një afati të arsyeshëm, në kuptim të nenit 42 të Kushtetutës

8. Kërkuesja pretendon se, që prej marrjes formë të prerë të vendimit nr. 540, datë 3.12.2007, të Gjykatës së Apelit Durrës, dhe lëshimit të urdhrin të ekzekutimit nr. 36, datë 21.1.2008, ka kaluar një kohë e gjatë dhe e pajustifikuar për ekzekutimin e vendimit gjyqësor.

9. Gjykata është shprehur edhe më parë se ekzekutimi brenda një afati të arsyeshëm i një vendimi të formës së prerë të gjykatës, është pjesë përbërëse e së drejtës për një proces të rregullt ligjor, në kuptim të Kushtetutës dhe të Konventës Europiane për të Drejtat e Njeriut (KEDNJ). Ekzekutimi i vendimit të formës së prerë të gjykatës konsiderohet si faza përfundimtare e realizimit të një të drejte të fituar gjyqësisht. Vetëm pas realizimit të kësaj faze mund të konsiderohet se individ i ka vendosur plotësisht në vend të drejtën e tij të fituar. Në këtë fazë duhet të marrin pjesë aktivisht jo vetëm palët, pra debitori dhe kreditori, por edhe organet kompetente të ngarkuara me ekzekutimin e vendimit gjyqësor të formës së prerë. Roli i këtyre organeve bëhet vendimtar, kur debitori refuzon të ekzekutojë vullnetarisht detyrimin e tij kundrejt kreditorit. Në raste të tilla, procesi i vendosjes në vend të një të drejte të shkelur përfshin jo vetëm vendimmarrjen e gjykatave për rastin konkret, por edhe veprimet konkrete të organeve përgjegjëse të ngarkuara me ekzekutimin e vendimeve gjyqësore të formës së prerë. Pa dyshim që një vonesë në ekzekutimin e një vendimi mund të justifikohet në rrethana të veçanta, por vonesa nuk mund të jetë deri në atë shkallë sa të dëmtojë thelbin e së drejtës (*shih vendimet nr. 1, datë 20.1.2012; nr. 2, datë 1.2.2011; nr. 35, datë 27.10.2010; nr. 6, datë 4.3.2010 dhe nr. 43, datë 19.12.2007 të Gjykatës Kushtetuese*).

10. Në vendimmarrjen e saj Gjykata ka pranuar se: “...parimet kushtetuese lidhur me procesin e rregullt ligjor, për të cilin bën fjalë neni 42/2 i Kushtetutës dhe neni 6 i KEDNJ-së, si dhe detyrimi për ekzekutimin e vendimeve gjyqësore, të parashikuara në nenin 142/3 të Kushtetutës, nënvizojnë faktin se çdo qytetar, i cili i drejtohet një gjykate kompetente për realizimin e një të drejte, nuk mund të presë pakufi për realizimin e saj”. Më tej, Gjykata ka pohuar se “...ekzekutimi i vendimit përbën një element thelbësor të shtetit të së drejtës e të vetë nocionit të gjykimit të drejtë. ... Çdo organ shtetëror detyrohet të marrë masat përkatëse për zbatimin e tyre” (*shih vendimet nr. 6, datë 6.3.2009; nr. 1, datë 19.1.2009; nr. 43, datë 19.12.2007 të Gjykatës Kushtetuese*).

11. Gjykata ka rikonfirmuar qëndrimin se, në një çështje që përfshin përcaktimin e një të drejte civile, kohëzgjatja e procedurave normalisht llogaritet nga momenti i fillimit të procedurës gjyqësore, deri në momentin kur jepet vendimi dhe ekzekutohet ai. Faza ekzekutive konsiderohet si fazë e mëtejshme e të njëjtit proces. Kohëzgjatja e arsyeshme e procedimeve, në kuptim të nenit 42 të Kushtetutës, duhet të vlerësohet nën dritën e rrethanave të çështjes dhe duke marrë në konsideratë kompleksitetin e çështjes, sjelljen dhe interesin e kërkuesit, si dhe sjelljen e autoriteteve përkatëse (*shih vendimet nr. 10, datë 1.3.2012; nr. 21, datë 3.6.2011; nr. 14, datë 15.4.2010; nr. 9, datë 1.4.2009 të Gjykatës Kushtetuese*).

12. Çështja konkrete është vlerësuar në vijim nga Gjykata në vështrim të respektimit të

standardeve të mësipërme.

i) Komplexiteti i çështjes

13. Në lidhje me kompleksitetin e çështjes, Gjykata ka pohuar vazhdimisht se, për vlerësimin e kompleksitetit të procedimeve duhet të kenë rëndësi të gjitha aspektet e çështjes, përfshi objektin e çështjes, faktet e kundërshtuara dhe volumin e provave shkresore. Komplexiteti i çështjes, në balancë me parimin e sigurimit të administrimit të përshtatshëm të drejtësisë, mund të justifikojë kohëzgjatje kohore të konsiderueshme (*shih vendimet nr. 7, datë 27.2.2012; nr. 50, datë 22.11.2011; nr. 14, datë 15.4.2010; nr. 8, datë 23.3.2010; nr. 9, datë 1.4.2009 të Gjykatës Kushtetuese*).

14. Çështja në shqyrtim ka për objekt mosekzekutimin e vendimit të formës së prerë brenda një afati të arsyeshëm, për sa i përket kthimit në punë dhe pagimit të kërkuarës për gjithë periudhën e qëndrimit pa punë, duke filluar nga data 31.5.2006 e deri në ekzekutimin e vendimit gjyqësor. Duke iu referuar materialeve shkresore, Gjykata konstaton se çështja konkrete nuk paraqet kompleksitet nga pikëpamja faktike ose ligjore, çka mund të justifikonte vonesat apo sjelljen mosvepruese të subjekteve të interesuara, përkatësisht Kapitenerisë së Porteve, Drejtorisë Detare, dhe Zyrës së Përmbartimit.

ii) Sjellja e kërkuarës

15. Gjykata, në jurisprudencën e saj, është shprehur se vlerësimi i sjelljes dhe i interesit të kërkuarës është një element tjetër përcaktues i kohëzgjatjes së arsyeshme të procedimeve (*shih vendimet nr. 50, datë 22.11.2011 dhe nr. 14, datë 15.4.2010 të Gjykatës Kushtetuese*).

16. Në çështjen, objekt shqyrtimi, Gjykata vëren se kërkuarja ka vepruar në përputhje me të drejtat e saj procedurale, duke shteruar mjetet ligjore në dispozicion për rivendosjen e së drejtës së cenuar. Nga tërësia e fakteve dhe rrethanave, rezulton se: kërkuarja, në datën 7.4.2008, ka depozituar pranë Zyrës së Përmbartimit urdhrin e ekzekutimit dhe kërkesën për zbatimin e vendimit gjyqësor të formës së prerë. Në datën 9.9.2008, në pritje të veprimeve përmbartimore, ajo i është drejtuar me kërkesë Drejtorit të Kapitenerisë së Porteve duke e bërë me dije për të drejtën e saj në bazë të vendimit gjyqësor të formës së prerë. Kërkuarja i është drejtuar në vijimësi edhe disa institucioneve shtetërore, si: Drejtorisë së Përgjithshme të Përmbartimit, Ministrisë së Drejtësisë, Avokatit të Popullit, dhe Kryeministrisë, të cilat kanë rekomanduar marrjen e masave për ekzekutimin e vendimit gjyqësor. Në datën 16.5.2011 kërkuarja ka depozituar në prokurori kallëzim penal ndaj Zyrës së Përmbartimit për mosmarrjen e masave ligjore për ekzekutimin e vendimit gjyqësor të formës së prerë. Nga sa më sipër, në vlerësimin e Gjykatës, nuk rezulton që sjelljet e kërkuarës të jenë bërë shkak për mosekzekutimin e vendimit të formës së prerë, përkundrazi ajo ka qenë aktive në kërkimet e saj për rivendosjen në vend të së drejtës së cenuar.

iii) Sjellja e autoriteteve

17. Për sa i përket sjelljes së autoriteteve, Gjykata ka theksuar se përballë detyrimit për zbatim të vendimeve gjyqësore të formës së prerë, të gjitha subjektet, qofshin këto private apo publike, duhet të përgjigjen njëjloj (*shih vendimet nr. 7, datë 27.2.2012; nr. 35, datë 27.10.2010; nr. 23, datë 17.5.2010 dhe nr. 1, datë 19.1.2009 të Gjykatës Kushtetuese*).

18. Mbi bazën e akteve shkresore të administruara, rezulton se Kapiteneria e Porteve ka kundërshtuar veprimet përmbartimore me anë të padisë në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Durrës, duke kërkuar pezullimin e ekzekutimit të vendimit gjyqësor të formës së prerë. Në lidhje me këtë kërkesëpadi, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Durrës, me vendimin nr. 1946, datë 25.6.2008, ka vendosur kthimin e akteve pasi adresa e kërkuarës, në cilësinë e të paditurës, nuk ka qenë e saktë. Në vijim, Drejtoria Detare, si institucion pasardhës i Kapitenerisë së Porteve, me anë të shkresës nr. 30, prot., datë 11.1.2011, i është përgjigjur Zyrës së Përmbartimit se “*personi juridik publik, Drejtoria e Përgjithshme Detare, nuk mbart asnjë lloj detyrimi nga ish-personi juridik publik Kapiteneria e Përgjithshme e Porteve Durrës*”. Pas ankesave të vazhdueshme të kërkuarës, Drejtoria Detare, me shkresën nr. 205/3 prot., datë 15.7.2011, ka pranuar njohjen e detyrimeve të ish-Kapitenerisë së Porteve dhe ka shprehur gatishmërinë për ekzekutimin e vendimit gjyqësor kur të krijohet mundësia brenda strukturës së saj. Nga këto veprime Gjykata konstaton se, nga momenti i nxjerrjes së urdhrit të ekzekutimit (datë 21.1.2008) e deri në pranimin e detyrimit ndaj kërkuarës nga Drejtoria Detare (datë 15.7.2011), kanë kaluar 3 vjet e gjysmë.

19. Referuar rikthimit në punë, Drejtoria Detare ka pretenduar pamundësinë objektive për të ekzekutuar vendimin e gjykatës, pasi vendi i mëparshëm i punës së kërkuarës (arkëtare-llogaritare) është

suprimuar. Për shkak të miratimit të një strukture dhe organike të re, kanë ndryshuar edhe kriteret e punës për pozicionin e ri të specialistes së financës, kriteret të cilat sipas Drejtorisë Detare, kërkesja nuk i përmbush. Gjykata, në jurisprudencën e saj, është shprehur se i takon debitorit të gjejë një mundësi zgjidhjeje sa më të përshtatshme për këtë rast, me qëllim vënien në vend të së drejtës së kreditorit (*shih vendimet nr. 10, datë 1.3.2012 dhe nr. 2, datë 1.2.2011 të Gjykatës Kushtetuese*). Gjykata vlerëson se autoritetet shtetërore nuk mund të justifikohen me pamundësinë objektive për të mos respektuar një detyrim që vjen nga një vendim gjyqësor, por duhet të përpiqen me të gjitha mjetet dhe mundësitë që kanë në dispozicion për ta zbatuar atë. Nisur nga ky arsytim, Gjykata çmon se argumentet e paraqitura nga Drejtoria Detare, lidhur me arsyet se përse nuk është ekzekutuar vendimi gjyqësor i formës së prerë, janë të pambështetura.

20. Autoriteti tjetër përgjegjës për ekzekutimin e vendimit, Zyra e Përmbarimit, fillimisht i është drejtuar debitorit (Drejtorisë Detare) me lajmërim për ekzekutim vullnetar (shkresa me nr. 864 prot., datë 21.4.2008). Në datën 27.12.2010, kjo zyrë, me shkresën nr. 184/10 prot., i ka kërkuar Drejtorisë Detare informacion nëse të drejtat dhe detyrimet e ish-Kapitenerisë së Porteve i janë transferuar Drejtorisë Detare, duke i lënë një afat 10 ditor për kthimin e përgjigjes. Pas përgjigjes së Drejtorisë Detare se ajo nuk mbart asnjë detyrim nga ish-Kapiteneria e Porteve, Zyra e Përmbarimit nuk ka kryer veprime të mëtejshme përmbarimore. Pasi kërkesja ka bërë kallëzim penal në prokurori ndaj Zyrës së Përmbarimit, kjo e fundit, në datën 13.6.2011, me shkresën nr. 09/118 prot., ka lëshuar urdhrin e ekzekutimit të detyrueshëm ndaj debitorit. Me vendimin nr. 09/118 prot., datë 25.8.2011, Zyra e Përmbarimit ka vendosur gjëritjen e debitorit, për moskryerjen e veprimit të caktuar, në masën 50.000 lekë. Me shkresën nr. 09/118 prot., datë 3.11.2011, Zyra e Përmbarimit ka depozituar pranë Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Durrës kallëzim penal ndaj Drejtorit të Përgjithshëm të Drejtorisë Detare, mbi të cilin është vendosur mosfillimi i procedimit penal. Në datën 12.1.2012, me vendimin nr. 09/118 prot., Zyra e Përmbarimit ka lëshuar urdhrin për vendosjen e masës së sekuestros në shpenzimet operative të debitorit, për detyrimin ndaj kërkuases, në masën 936.849 lekë.

21. Në vështrim të fakteve dhe argumenteve të parashtuara, vërehet se kanë kaluar 4 vjet e 10 muaj që nga data kur ka dalë urdhri i ekzekutimit, i cili ende nuk është zbatuar. Në vlerësimin e Gjykatës, autoritetet shtetërore përgjegjëse nuk kanë pasur asnjë pengesë ligjore për të ekzekutuar vendimin gjyqësor të formës së prerë.

22. Për sa më sipër, Gjykata nuk gjen arsye të bazuara që kanë çuar në mosrealizimin e së drejtës së kërkuases për një proces të rregullt ligjor. Gjykata vlerëson se në çështjen në shqyrtim, Kapiteneria e Porteve dhe më pas Drejtoria Detare i kishin të gjitha mundësitë që të ekzekutonin vendimin gjyqësor të formës së prerë.

23. Si përfundim, në çështjen objekt shqyrtimi, Gjykata vlerëson se mosekzekutimi i vendimit gjyqësor të formës së prerë, brenda një afati të arsyeshëm, ka sjellë cenimin e së drejtës së kërkuases për një proces të rregullt ligjor, të parashikuar nga neni 42 i Kushtetutës dhe neni 6/1 i KEDNJ-së.

PËR KËTO ARSYE,

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, në mbështetje të neneve 131/f dhe 134/g të Kushtetutës, si dhe në nenin 72 të ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, njëzëri,

VENDOSI:

- Konstatimin e cenimit të së drejtës kushtetuese për një proces të rregullt ligjor, si rrjedhojë e mosekzekutimit të vendimit gjyqësor të formës së prerë nr. 540, datë 3.12.2007 të Gjykatës së Apelit Durrës.

- Ky vendim është përfundimtar, i formës së prerë dhe hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare.

Anëtarë: Bashkim Dedja (kryetar), Xhezair Zaganjori, Vladimir Kristo, Admir Thanza, Fatmir Hoxha, Vitore Tusha, Sokol Berberi, Altina Xhoxhaj